

STATUT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"Nur Salon" Sh.p.k.

KAPITULLI I
EMRI, FORMA E SHOQËRISË, SELIA, OBJEKTI, KOHËZGJATJA

Neni 1

Themelimi

Emri i shoqërisë është "Nur Salon" Sh.p.k., këtu më poshtë e quajtur "Shoqëria". Shoqëria është themeluar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Statutin.

Neni 2

Selia

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Njesia Bashkiake nr.5, Rruga "Muhamet Gjollesha", Hyrja 1, Apartamenti 1, Zona Kadastrale 8270, Tiranë.
- 2.2 Shoqëria mund të themelojë degë, filiale dhe/ose zyra përfaqësimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe/ose në shtete të tjera, në përputhje me ligjet e zbatueshme dhe Statutin.

Neni 3

Objekti

- 3.1 Objekti i Shoqërisë do të jetë:

A. Trajtim Parukerie, çdo veprimtari tjetër e ligjshme.

- 3.2 Kryerja e aktiviteteve, për të cilat nevojiten leje, licenca dhe/ose autorizime përkatëse, do të bëhet pas marrjes së këtyre lejeve, licencave dhe/ose autorizimeve.

Neni 4

Kohëzgjatja

- 4.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar.

KAPITULLI II

KAPITALI FILLESTAR THEMELTAR, KONTRIBUTET, KUOTAT-PJESËT E KAPITALIT

Neni 5

Kapitali Themeltar dhe Ortakët

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100,000 (njëqindmije) Lekë.
5.2 Kapitali i Shoqërisë zotërohet nga Ortakët e mëposhtëm:

Sara Vorpsi, shtetase shqiptare, lindur më 14.03.2000, banuese në Tiranë, me numër personal K05314032V, zotëruese e një kuote të Shoqërisë, me vlerë 33,000 (tridhjetetremije) Lekë, duke përfaqësuar 33% të kapitalit themeltar me të drejtë vote.

Eva Qosja, shtetase shqiptare, lindur më 28.04.2000, banuese në Tiranë, me numër personal K05428013T, zotëruese e një kuote të Shoqërisë, me vlerë 33,000 (tridhjetetremije) Lekë, duke përfaqësuar 33% të kapitalit themeltar me të drejtë vote.

Anife Borri, shtetase shqiptare, lindur më 18.04.2003 banuese në Tiranë, me numër personal K35418069J, zotëruese e një kuote të Shoqërisë, me vlerë 34,000 (tridhjetetremije) Lekë, duke përfaqësuar 34% të kapitalit themeltar me të drejtë vote.

- 5.3 Kapitali themeltar është nënshkruar dhe shlyer plotësisht me kontribute në para nga Ortaket me themelimin e Shoqërisë.
5.4 Përgjegjësia e Ortakut shtrihet deri në shumën e kontributit të saj në kapitalin e Shoqërisë.

Neni 6

Transferimi i Pjesëve-Kuotave

- 6.1 Çdo Ortak mund t'ja transferojë pjesët e tij në kapitalin e Shoqërisë çdo pale të tretë, me kusht që Ortaku transferues t'u ketë njoftuar më parë me shkrim Ortakëve të tjerë të paktën 1 (një) muaj para ("Periudha e Njoftimit") numrin e pjesëve për t'u shitur, çmimin e shitjes, identifikimin e palës së tretë dhe çdo kusht tjetër lidhur me transferimin e pjesëve. Ortakët e tjerë duhet t'i përgjigjen njoftimit të Ortakut transferues nëse dëshirojnë të blejnë pjesët sipas kushteve të vendosura në njoftim brenda Periudhës së Njoftimit. Në rast të një përgjigjeje negative ose nëse Periudha e Njoftimit kalon pa përgjigje, Ortaku transferues mund të procedojë me transferimin e pjesëve te pala e tretë.



KAPITULLI III

ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

Neni 7

Asambleja e Përgjithshme

- 7.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me dispozitat e këtij Statuti, janë të detyrueshme për të gjithë Ortakët, pavarësisht janë apo jo të pranishëm në mbledhje, janë apo jo dakord me këto vendime.
- 7.2 Asambleja e Përgjithshme ka funksionet e mëposhtme:
- Përcakton politikat tregtare dhe ekonomike të Shoqërisë dhe mbikëqyr zbatimin e këtyre të fundit nga administratorët;
 - Emëron dhe shkarkon administratorët;
 - Emëron dhe shkarkon ekspertin(ët) kontabël dhe/ose likuiduesin(it) e Shoqërisë: Përcakton shpërblimin e administratorëve, ekspertëve kontabël dhe likuiduesve; Miraton pasqyrat financiare vjetore dhe raportet e ecures së veprimtarisë të përgatitura nga administratorët;
- Merr vendim për ndryshimet e këtij Statuti dhe të Aktit të Themelimit;
- Merr vendim për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë;
- Merr vendim për shpërndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve;
- Merr vendim për riorganizimin e Shoqërisë ose prishjen e saj;
- Merr vendim për çdo çështje tjetër të parashikuar nga ligji.

Neni 8

Thirrja

A stylized handwritten signature in blue ink, featuring a large loop and a crossbar.A handwritten signature in blue ink, consisting of a series of connected loops and a final horizontal stroke.A handwritten signature in blue ink, featuring a large loop and a crossbar.

- 8.1 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të thirret nga Administratori(rët), ose secili prej Ortakëve sipas legjislacionit në fuqi.
- 8.2 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme zhvillohet normalisht në selinë e Shoqërisë ose në një vend tjetër brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.
- 8.3 Asambleja e Përgjithshme shprehet në mënyrë të veçantë për çdo çështje të rendit të ditës, për të cilën duhet të merret një vendim i veçantë.
- 8.4 Ortakët mund të marrin pjesë në Asamblenë e Përgjithshme personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar me prokurë. Administratori(ët) e Shoqërisë nuk mund të përfaqësojnë Ortakët në Asamblenë e Përgjithshme.

Neni 9

Procesi i vendimarrjes

- 9.1 Asambleja e Përgjithslune mblidhet sa herë që është e nevojshme, por në cdo rast të paktën një herë në vit.
- 9.2 Asambleja e Përgjithshme quhet e mbledhur rregullisht kur janë të pranishëm Ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë me shumë se 30% të kuotës të Shoqërisë. Në mungesë të kuorumit të kërkuar, mbledhja shtyhet për 30 (tridhjetë) ditë, me të njëjtin rend dite.
- 9.3 Asambleja e Përgjithshme merr vendime me shumicë të thjeshtë, në lidhje me çështje për të cilat ligji nuk kërkon një shumicë të cilësuar, përcaktuar në pikën 9.4 më poshte.
- 9.4 Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicë të cilësuar prej $\frac{3}{4}$ të votave të ortakëve të pranishëm në lidhje me:
- i. Ndryshimin e Statutit;
 - ii. Rritjen dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - iii. Shpërndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve;
 - iv. Riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.
- 9.5 Asambleja e Përgjithshme për vendimet sipas pikës 9.4 quhet e mbledhur rregullisht kur janë të pranishëm Ortakët që zotërojnë më shumë se 50% të kuotave të Shoqërisë. Në mungesë të kuorumit të kërkuar, mbledhja shtyhet për 30 (tridhjetë) ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 10




Administratori

- 10.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administrator/ë, i/të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme.
- 10.2 Administratori i parë i Shoqërisë është:

Anife Borri, shtetase shqiptare, lindur më 18.04.2003, banuese në Tiranë, me numër personal K35418069J, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

- 10.3 Mandati i Administratorit është për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh, i rinovueshëm, dhe, nëse është rasti, vazhdon deri në vendimin e ardhshëm të Asamblesë së Përgjithshme që do të marrë vendim në lidhje me rinovimin e mandatit të tij apo emërimin e administratorit të ri.
- 10.4 Shoqëria përfaqësohet ndaj të tretëve nga Administratori.
- 10.5 Përveçse kur parashikohet ndryshe me vendimin përkatës të Asamblesë së Përgjithshme për emërimin e administratorit, ai ka të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:
- Administrimin e veprimtarisë së Shoqërisë duke zbatuar politikat tregtare dhe ekonomike të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme;
 - Përfaqësimin e Shoqërisë në marrëdhënie me çdo palë të tretë;
 - Marrjen e masave për hartimin dhe mbajtjen në mënyrën e duhur të pasqyrave financiare dhe të dokumenteve;
 - Përgatitjen dhe nënshkrimin e pasqyrave financiare vjetore dhe bilanceve të konsoliduara, përgatitjen e raportit të ecurisë dhe dorëzimin e këtyre të fundit bashkë me propozimin përkatës për shpërndarjen e fitimeve Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
 - Dorëzimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit të dokumenteve dhe të dhënave të Shoqërisë, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe;
 - Raportimin në Asamblenë e Përgjithslune të Ortakëve në lidhje me zbatimin e politikave tregtare të Shoqërisë dhe në lidhje me përmbushjen e transaksioneve të një rëndësie të vecantë për ecurinë e Shoqërisë;
 - Kryerjen e çdo detyre tjetër të parashikuar nga ligji ose nga ky Statut.
- 10.6 Administratori mund të autorizojë nëpërmjet një prokure, një palë të tretë të përfaqësojë Shoqërinë dhe të nënshkruajë çdo dokument, kërkesë ose aplikim në



- emër dhe për llogari të Shoqërisë.
- 10.7 Administratori është përgjegjës ndaj Shoqërisë për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e mospërbushjes së detyrimeve të parashikuara nga dispozitat e këtij Statuti dhe legjislacioni në fuqi.

KAPITULLI IV

VITI FINANCIAR - SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 11

Viti Financiar

- 11.1 Viti financiar fillon më 1 Janar dhe përfundon në 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik. Në përfundim të vitit kalendarik, Administratori miraton pasqyrat financiare të Shoqërisë në përputhje me ligjet në fuqi.
- 11.2 Viti i parë financiar fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe përfundon më 31 Dhjetor 2025.

Neni 12

Shpërndarja e Fitimeve

- 12.1 Pas miratimit të pasqyrave vjetore financiare dhe në rast se janë realizuar fitime, Asambleja e Përgjithshme vendos në lidhje me shpërndarjen ose jo të tyre.
- 12.2 Në rast se pas miratimit të pasqyrave vjetore financiare Shoqëria rezulton me humbje, Asambleja e Përgjithshme vendos në lidhje me mbulimin e tyre.

KAPITULLI V

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 13

Ligji i Zbatueshëm

- 13.1 Për të gjitha çështjet që nuk parashikohen në këtë Statut, do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në lidhje me shoqëritë tregtare.

Neni 14

Të ndryshme

- 14.1 Ky Statut është hartuar dhe nënshkruar në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe, me të njëjtën vlerë secila.

Tiranë, me 24.08.2025

ORTAKËT E SHOQERISË

Sara Vorpsi

Sara vorpsi



Eva Qosja

Eva Qosja



Anife Borri

Anife Borri

